



5073/24  
30 SEP 2024

## KOMUNA E GRAÇANICËS

Graçanicë, 30.09.2024

### **Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve-programeve të OJQ-ve me qëllim të zbatimit të masave mbështetëse për qytetarët në situatë të vështirë materiale**

1. Komuna e Graçanicës fton të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ) të cilat janë të regjistruara dhe programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e veprimtarisë humanitare, të aplikojnë për mbështetje financiare për zbatimin e masave mbështetëse për qytetarët në situatë të vështirë materiale.

2. OJQ-të në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programe për aktivitetet e mëposhtme:

- Sigurimi dhe shpërndarja e pakove me ushqime esenciale për personat në nevojë;
- Sigurimi dhe shpërndarja e pakove me mjete higjienike për personat në nevojë;
- Sigurimi dhe shpërndarja e druve për ngrohje për familjet në nevojë.
- Ndihma për të sëmurët, të moshuarit dhe personat që jetojnë vetëm në formë të shërbimeve gerontologjike;
- Sigurimi i qasjes së kujdesit esencial mjekësor nga personeli mjekësor profesional për anëtarët në nevojë të komunitetit që nuk kanë ose kanë qasje të vështirë në shërbime shëndetësore;
- Mbështetje për vetëpunësim;
- Aktivitete të tjera që përfaqësojnë mbështetje për qytetarët në gjendje të vështirë materiale.

3. OJQ-ja mund të paraqesë vetëm një projekt me të cilin do të përfshihen aktivitetet e parapara në pikën 2 të kësaj Thirrjeje publike.

4. Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 100.000,00 (njëqind mijë) euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 10.000,00 (dhjetë mijë) euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 100.000,00 (njëqind mijë) euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 01.10.2024, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është 21.10.2024.

6. Të drejten në aplikim e kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Graçanicës dhe që veprojnë dhe janë të regjistruara së paku tre vjet para datës së publikimit të Thirrjes publike. OJQ-ja që dorëzon aplikacionin duhet të paraqesë dëshmi se ka qenë e përfshirë në realizimin e

projekteve të këtij lloji në tre vitet e fundit, si dhe se nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare nga Komuna e Graçanicës, të njëjtat i ka arsyetuar me paraqitjen e raportit financiar.


Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të ofrojnë dëshmi se personi përgjegjës në OJQ-në dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe dëshmi se OJQ-ja ka zgjidhur të gjitha çështjet e hapura në lidhje me pagesën e kontributeve dhe taksave të papaguara.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Graçanicës-[kk.rks-gov.net/gracanice](http://kk.rks-gov.net/gracanice)*. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: *Komuna e Graçanicës, rruga "Car Lazar" pn 10500 Graçanicë*.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit.

Do të konsiderohen vetëm propozimet që janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e aplikacioneve dhe në formë të përcaktuar me Thirrjen publike.

8. Të gjitha çështjet në lidhje me Thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [opstinagracanica@gmail.com](mailto:opstinagracanica@gmail.com)



Kryetarija e komunës  
*[Signature]*  
Prof.dr. Ljiljana Šubarić